



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice
Kabineti i Ministrit - Ured Ministra - Office of the Minister

Nr. 107 /2021
Datë: 02/07/2021

Në mbështetje të nenit 10 (paragrafi 1 dhe 2), dhe nenit 11 të Ligjit nr. 06/L-113 për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura (GZ, Nr.7/01 mars 2019), duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 1, nën paragrafi 1.4) të Rregullores (QRK)-Nr.21/2021 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive, (30.03.2021), ministrja e Drejtësisë, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Z. Rasim Selmani, Zëvendësues i Zv. Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës caktohet Zëvendësues i Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës.
2. Zëvendësuesi sipas pikës 1 të këtij vendimi obligohet që detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës, t'i kryej në pajtim me dispozitat përkatëse të legjislacionin në fuqi.
3. Zëvendësuesi sipas pikës 1 të këtij vendimi caktohet për periudhën e përcaktuar me dispozitat përkatëse të legjislacionit në fuqi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

A r s y e t i m

Bazuar në Vendimin Nr. 0366 të datës 18.06.2021, të Këshillit Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë, me të cilin vendim z. Nehat Thaçi, Drejtor i Përgjithshëm i Shërbimit

Korrektues të Kosovës, i është shqiptuar masa disiplinore “Largim nga Shërbimi Civil”, për shkelje të rënda gjatë ushtrimit detyrave të punës.

Më qëllim të kryerjes së detyrave dhe përgjegjësisë të përcaktuara me legjislacionin përkatës në fuqi, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

për: **Albulena Haxhiu**

Ministre e Drejtësisë


Vendimi i dërgohet:

- Z. Rasim Selmani;
- Kabinetit të ministres të Drejtësisë;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm/MD;
- Shërbimit Korrektues të Kosovës;
- Arkivit.